



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:203434

Datë: 30.12.2024

Numri i dokumentit: 06669210

PAKR.nr.309/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri - Kryetar i kolegjit, Vaton Durguti dhe Skender Çoçaj - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit K.G., nga fshati Peqan të Komunës së Suharekës, për shkak të veprës penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit K.G. av. M.Q. si dhe ankesën e të dëmtuarit S.B., të paraqitura kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.143/2021 të datës 11.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform neni 390 të KPPK, me datë 11.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e pjesshëm të ankesave përf.ligjor-dëmtuarin S.B. dhe Prokurorisë Themelore në Prizren, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.143/2021 të datës 11.04.2024, përkitazi me dënimin plotësues konform neni 59 par.1 dhe 2 e lidhur me nenin 64 të KPK-së, ashtu që kjo Gjykatë të akuzuarit K.G., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, i shqipton edhe masën e ndalimit të drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej dy (2) vite, e do të ekzekutohet pas mbajtjes së dënimit me burgim. Në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar mbetet i paprekur.

II. Në pjesën tjetër ankesat e përf.ligjor-dëmtuarit S.B. dhe Prokurorisë Themelore në Prizren përkitazi me lartësinë e sanksionit penal-dënim, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit K.G av.M.Q. REFUZOHEN si të pabazuara.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.143/2021 të datës 11.04.2024, të akuzuarin K.G. e ka shpallur fajtor për veprën penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muajve , në të cilin dënim me burgim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 12.09.2021 gjer më 08.10.2021. I dëmtuari S.B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Është obliguar i akuzuari K.G. që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën- dhe atë shpenzimet për ekspertizë të komunikacionit për ekspertin E.Q. 50 euro, shpenzimet e super ekspertizës në shumë prej 740 euro, paushallin gjyqësor në shumë prej 1000 euro, si dhe shumë prej 50 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ankimuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar: Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës të aprovoj ankesën si të bazuar ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar me qëllim që të akuzuarit t'i shqiptoj dënim me burgim efektiv më të lartë me të cilin dënim do të arrihet në mënyrë të plotë qëllimi i dënimit.

I dëmtuari S.B. për shkak të sanksionit penal mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj në tërësi ankesën e palës së dëmtuar, të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit K.G.. t'i shqiptohet një dënim më i lartë, mbi minimumin e dënimit të sanksionuar për veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.G. av. M.Q., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj si të bazuar në tërësi ankesën ashtu që aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim më të butë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat lehtësuese dhe posaçërisht lehtësuese duke aplikuar dhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara për zbutjen e dënimit sepse në rastin konkret janë plotësuar të gjitha rrethanat dhe elementet që kërkohen për një zbutje të tillë.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/II.nr.286/2024 të dt.24.05.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren ashtu që të ndryshohet aktgjyrimi i ankimuar dhe të akuzuarit K.G. t'i shqiptohet dënim me burgim efektiv më të lartë, të aprovohet ankesa e palës së dëmtuar S.B. për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal ndërsa të refuzohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit K.G. av. M.Q. si e pabazuar.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-se në të cilën ka prezantuar i akuzuari K.G., mbrojtësi i të akuzuarit av.M.Q. si dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar av.Sh.Z., ndërsa nuk ka prezantuar askush nga palët tjera edhe pse të njëjtit kanë qenë të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK-së, vlerësoi pretendimet ankimore të paraqitura nga Prokuroria Themelore në Prizren, i dëmtuari S.B. dhe mbrojtësi i të akuzuarit K.G. av. M.Q. dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se: Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe e perf.ligjor-dëmtuarit S.B. është pjesërisht e bazuar ndërsa ankesat mbrojtësi i të akuzuarit K.G. av. M.Q. është e pabazuar.

Pretendimet ankimore

Në ankesë Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren pretendon aktgjyrimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe atë të nenit 59 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 lidhur me nenin 64 të KPRK-së, rrjedhimisht në shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht nenit 385 të KPRK-së, për faktin se gjykata nuk ka marrë vendim me lidhur me shqiptimin e dënimit

plotësues - Ndalim i drejtimit të automjetit ndaj të akuzuarit K.G., shqiptimi i të cilit dënim plotësues ka qenë i propozuar edhe në aktakuzë. Po ashtu Prokurori i shtetit konsideron se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me këtë çështje penale dhe të njëjtin e ka shpallur fajtor, por nuk ka caktuar drejtë lartësinë e dënimit, duke mos i vlerësuar dhe peshuar drejt të gjitha rrethanat, si ato rënduese ashtu edhe ato lehtësuese me rastin e matjes së dënimit. Gjykata e shkallës së parë gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e tij ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat edhe i ka listuar një nga një, mirëpo gjykata nuk i ka shtjelluar drejt se pse këto rrethana kanë ndikuar në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë faktin se i dënuari ka rënë për herë të parë ndesh me ligjin, se është i martuar dhe ka 3 fëmijë, se në kohën e kryerjes ka qenë i moshës tridhjetë e tre (33) vjeçar dhe se gjykata ia shqipton dënimin nën minimumin e paraparë ligjor nga fakti se edhe i ndjeri - viktimja ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit dhe se konform nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Kodit Penal, gjykata ka ardh në përfundim se edhe me shqiptimin e dënimit të tillë më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit. Prokurori i Shtetit vlerëson se gjykata në rastin konkret nuk ka pasur asnjë rrethanë që konform nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Kodit Penal, që gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptoj lloj më të butë të dënimit, gjegjësisht sipas të cilit nën paragraf qëndron: “kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë”, pasi në rastin konkret nga provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde nuk qëndron asnjë rrethanë lehtësuese e aq me pak posaçërisht lehtësuese. Sa i përket moshës ai nuk mund të konsiderohet i moshës së re e aq më pak kur i njëjti është baba i tre fëmijëve dhe me vetëdije të plotë e ka sjellë veten në gjendje të dehur dhe në këtë gjendje ka vendosë të drejtojë automjetin. Në qenurit prind i tre fëmijëve në moshën tridhjetë e tre (33) vjeçare nuk duhet të vlerësohet si rrethana lehtësuese, gjegjësisht mosha e tij të cilën Gjykata e ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese, pasi kjo tregon një papërgjegjshmëri të tij për të vepruar në mënyrën si ka vepruar ditën kritike, gjegjësisht duke e sjellë veten në gjendje të dehur dhe duke dalë në komunikacion me këtë gjendje. Sa i përket vlerësimit të gjykatës se shqiptimi i dënimit nën minimumin e paraparë ligjor është bërë për faktin se i ndjeri ka kontribuar që të vie deri tek aksidenti ditën kritike në asnjë nga pikat e parapara në nenin 70 paragrafi 3 të Kodit të Penal, kjo nuk është rrethanë lehtësuese dhe se gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor në bazë të provave të administruara nuk ka ardh në përfundim se në rastin konkret ekziston përgjegjësi solidare në shkaktimin e aksidentit ditën kritike, nga provat të cilat janë administruar qartë është bërë e ditur se ka qenë i akuzuari ai i cili ka kaluar me automjetin e tij në shiritin e kahjes së kundërt në distance prej 15

cm, ndërsa për tani të ndjerin A.B., është konstatuar se ka qenë në shiritin e tij të lëvizjes, duke lëvizur në afërsi të mesit të rrugës, andaj kërkojmë që Gjykata e Apelit këtë vlerësim të Gjykatës së shkallës së parë, të vlerësoj si të paqëndrueshëm dhe jo në përputhje me nenin 70 dhe 71 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Po ashtu gjykata nuk i ka arsyetuar rrethanat rënduese se si të njëjtat kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, e njëjta ka marrë si rrethanë rënduese vetëm pasojën e shkaktuar me vepër penale dhe dhimbjen e shkaktuar familjes, ndërsa fare nuk ka marrë parasysh shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të dënuarit në kryerjen e veprës penale dhe shkallën e lartë të dashjes nga ana e të dënuarit, ku i njëjti duke e ditur se edhe pse që vozitja në gjendje të dehur është e ndaluar me ligj dhe është vepër penale, ai konsumon alkool dhe e sjell veten në gjendje të dehur ku si rezultat i saj vie deri te shkaktimi i aksidentit ku si pasojë vdes viktima A.B. Drejtimi i automjetit nga ana e të dënuarit në gjendje të dehur nuk është cekur nga ana e gjykatës si rrethanë e cila ka ndikuar në shkalën e lartë të pjesëmarrjes të dënuarit në veprën penale, se i njëjti ka qenë i vetëdijshëm se me konsumimin e alkoolit do të vihet në gjendje të paafte për drejtimin e automjetit duke mos rrezikuar jetën e të tjerëve e që në rastin konkret ka rezultuar me shkaktimin e aksidentit dhe vdekjen e një personi. Dënimet e shqiptuara në rastet e drejtimit të automjetit në gjendje të dehur dhe shkaktimin të aksidentit në këtë gjendje në raport me aksidentet e shkaktuara nga pakujdesia, duhet të dallohen dukshëm pasi drejtimi i automjetit në gjendje të dehur është një gjendje në të cilën sillet personi me vetëdije të plotë, me vullnetin e tij të lirë dhe duke i marrë parasysh të gjitha pasojat e rrezikshme që i sjell drejtimi i automjetit në këtë gjendje dhe fakti se drejtimi i automjetit në gjendje të dehur është e ndaluar me ligj, në të cilën gjendje këtu i dënuari, K.G., i ka marrë parasysh se pasoja e rrezikshme mund të shkaktohet e që në rastin konkret fatkeqësisht ka rezultuar edhe me humbjen e një jete. Pasoja e shkaktuar me veprimet e personit të dënuar, pasoja këto të përjetshme për anëtarët e tij të familjes, assesi nuk mund të arsyetohet me dënimin e ulët të shqiptuar ndaj këtu të dënuarit. Gjykata nuk ka marrë parasysh faktin se i njëjti nuk i ka shprehur keqardhje familjes së viktimës dhe as pendimin për veprimet e tij, tregon qartë se një dënim i tillë është i ulët dhe se me të njëjtin nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, andaj mbi këto rrethana prokuroria ka propozuar si më lartë.

I dëmtuari S.B. në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit nuk ka marrë parasysh rrethanat rënduese, ashtu që me këtë vendimmarrje të saj, konsideroj se i akuzuari është favorizuar. Për më tepër, kjo vendimmarrje fare nuk është ligjore dhe se vërtetimi i një vendimi të tillë nga Gjykata e Apelit e Kosovës nuk do të ndikonte në qëllimin e dënimit. Sa më lartë, në pjesën e arsyetimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë si rrethanë lehtësuese, gjykata ka vlerësuar kontributin e të ndjerit, mirëpo kjo në asnjë

mënyrë nuk duhet të barazohet me humbjen e një jete. Humbja e jetës dhe atë në moshë të re nuk do duhej të përbënte në asnjë formë ose mënyrë shkak për zbutjen e dënimit. I dëmtuari konsideron se kjo zbutje e dënimit është e padrejtë, kjo si nga fakti i lartcekur, por edhe nga ajo që gjykata përkundër shumë ekspertizave të komunikacionit të administruara, ende nuk dihet se në bazë të cilës ka ardhur në kontributin e të ndjerit, kjo sepse nga analizimi i tërësishëm i arsytimit të vendimit, askund nuk vërehet se gjykata e shkallës së parë cilës prej provave - ekspertizave të komunikacionit ia ka falur besimin e cilës jo, me sqarimet tjera se pse njëri është falur besimi e pse tjetri jo. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë fare nuk ka dhënë vlerësimet juridike edhe ndaj ekspertizës së ekspertit, N.D., i cili në ekspertizën e tij, të ndjerin nuk e paraqet si person që ka kontribuar në shkakimin e aksidentit rrugor. Andaj, mungesa e prezencës së analizimit me të hollësishëm të provave të lartcekura nga ana e gjykatës së shkallës së parë, duke u mjaftuar vetëm me përshkrimin e ekspertizave, e që kjo sjajon vërtetim jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, themi se assesi nuk përlligj zbutjen e dënimit që gjykata e shkallës së parë ka bërë ndaj të akuzuarit, për dallim nga obligimi ligjor i shqiptimit të dënimit, që parashihet me nenin 371, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës. Kësisoj themi se gjykata nuk ka synuar të jetëson efektin - qëllimin e dënimit nga neni 38 të Kodit Penal të Kosovës. Pra, nëse Gjykata e Apelit e Kosovës do të vërteton një vendim të tillë, atëherë ky dënim të i akuzuari do të shkakton ndjenjën që të përdor përsëri alkool, dhe nga kjo të shkakton prapë vepra të tilla ose të ngjashme. Çuditërisht, në mungesë të shqiptimit të dënimit plotësues nga gjykata e shkallës së parë, i dëmtuari i propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës që të akuzuarit t'i shqipton edhe dënim plotësues dhe atë ose ndalimin e drejtimit të automjetit, ose marrjen e lejes së vozitjes, kjo nga arsyeja e vetme që persona, familjarë të tjerë mos të përjetojnë dhimbje shpirtërore sikurse unë. Përmbledhur sa më lart, Gjykatës së Apelit të Kosovës i propozoj pas analizimit të shkresave të lëndës, e në veçanti ankesës së palës së dëmtuar, të aprovon të njëjtën, të ndryshon vendimin e gjykatës së shkallës së parë në drejtim të ashpërsimit të dënimit kundrejt të akuzuarit, si dhe të njëjtit t'i shqipton dënim plotësues, pasi me një dënim më të lartë, si dhe dënim plotësues, t i akuzuari por jo vetëm do të arrihet qëllimi i dënimit, si dhe njëherit do të ndikohej në emancipimin e shoqërisë që vepra të tilla penale të mos përsëriten më asnjëherë. Mbi këto rrethana ka propozuar si më lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.G. av. M.Q., në ankesë thekson se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale të KPPRK-së të parapara sipas nenit 384, për faktin se gjykata nuk ka arritur që të paraqes arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare që drejtpërdrejtë kanë ndikim në vërtetimin e veprës penale në veprimet e të akuzuarit K.G. Në

aktgjykim nuk janë paraqitur arsyet e mjaftueshme për faktet kontestuese dhe dilemat që ekzistojnë dhe që dalin si rezultat i gjetjeve të konstatuara nga provat e administruara. Gjykata e shkallës së parë edhe për kundër faktit se ka administruar provat e propozuara nga prokurori i shtetit, nuk ka arrit të vërtetoj saktësisht pikën goditëse e cila ndikon esencialisht në përcaktimin e përgjegjësisë penale. Këtë dilemë nuk e ka heq edhe përkundër faktit se ekspertët e komunikacionit kanë deklaruar se në rrethanat kur kjo pikë goditëse është paraqitur në skicën e policisë, pa sqarimin e zyrtarit policor i cili ka konstatuar këtë fakt në skicën e punuar në vendin e ngjarjes, është e pamundur të konstatohet se në çfarë rrethana dhe në çka është bazuar zyrtari policor kur ka vendos të jap një konstatim të tillë. Mbrojtësi i të akuzuarit, ka propozuar që në shqyrtimin gjyqësor të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit zyrtari policor i cili kishte hartuar raportin nga vendi i ngjarjes, dëgjimi i këtij dëshmitari kishte me evituar shumë dilema që tani ekzistojnë duke filluar nga përgatitja profesionale dhe kompetenca e këtij zyrtari policor për tu konsideruar si jo kontestuese konstatimet e tij. Do të sqaronte se ku e ka bazuar konstatimin e vet përderisa ai vet dhe ekspertët kanë konstatuar se në rrugë në vendin ku ka ndodh aksidenti nuk ka pas gjurmë frenimi të gomave, që do të përcaktonin pozitën e secilit automjet para se të ndodh dhe në momentin kur ka ndodhur aksidenti. Në këto rrethana kur gjykata e shkallës së parë, e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për dëgjimin e këtij dëshmitari pa dhënë asnjë arsyetim që do të ishte i pranueshëm, konsideroj se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 7 të Kodit të procedurës penale, sepse ka vepruar në kundërshtim me kërkesën ligjore që gjykata dhe çdo autoritet tjetër që vepron në procedurën penale ka për obligim dhe detyrohet që saktësisht dhe tërësisht ti vërtetoj faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. Në rastin konkret edhe pse dëgjimi i këtij dëshmitari kish me ndiku esencialisht në vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, gjykata e ka refuzuar pa asnjë arsye të bazuar. Se gjykata nuk ka arrit të i vërtetoj të gjitha faktet vendimtare dhe nuk ka paraqitur arsyetim të plotë për faktet që i ka marrë të vërtetuara, del edhe nga konstatimi i gjykatës në dispozitiv të aktgjykimit duke e shpall të akuzuarin fajtor se ai është shkaktar i aksidentit që është objekt i aktgjykimit. Me këtë rast gjykata nuk ka paraqitur se i akuzuari mund të ketë dhënë kontribut në çfarë niveli dhe shkalle ka ndikuar që të shkaktohet aksidenti përderisa ekspertët e komunikacionit të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor kanë konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e pakujdesisë edhe nga viktimi i cili në momentin kritik ka kryer lëvizje të pa rregullta në shirit në afërsi të vijës ndarëse të shiritave por që në terren dhe nga ekspertët është konstatuar se kanë përgjegjësi edhe autoritetet përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve sepse në rrugë nuk ka pasur asnjë shenjë horizontale, vijë apo çfarëdo shenje tjetër që dallon shiritin lëvizës, mesin e rrugës dhe që në rrethana të ekzistimit të tyre sigurisht do të

ndikonin që të mos kishte ardhur tek aksidenti me pasoja. Përcaktimi i shkallës dhe nivelit të kontributit në kryerjen e veprës penale, do të përcaktonte edhe nivelin e përgjegjësisë së ndarë që në mënyrë të drejtpërdrejtë do të përcaktonte edhe ekzistimin ose jo të veprës penale si dhe eventualisht shkallës e përgjegjësisë penale. Mbrojtja tutje shton se gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore seancat e shqyrtimit kryesor pa u dëgjuar pala e dëmtuar dhe as nuk është lexuar deklarata e tij që në rrethana të një gjykimi të tillë duhet pas parasysh pasojat dhe ndikimi që ka deklarimi i palës së dëmtuar në procedurën gjyqësore, në dëm ose në favor të akuzuarit, konsideroj se është lëshim procedural. Një lëshim tjetër procedural lidhet me faktin se gjykata nuk i ka dhënë mundësi të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij të deklarohen për mbajtjen e seancës së vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese siç përcakton dispozita e nenit 356 të Kodit të procedurës penale. Në këto rrethana, të akuzuarit i është mohuar e drejta që para trupit gjykues ti paraqes mbrojtjen e tij të plotë dhe në drejtim të paraqitjes së rrethanave lehtësuese që mund të kishin ndikim të drejtpërdrejtë në matjen e dënimit dhe lartësinë e tij. Këto dhe lëshimet tjera që gjykata e shkallës së parë, i ka bërë kanë ndikuar që gjykata të nxjerrë një aktgjykim me shkelje esenciale shkelje që kanë ndikuar esencialisht në vendimin e gjykatës. Mbrojtja më tej shton se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë edhe me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ngase i akuzuari për gjatë procedurës, ka shprehur keqardhje për aksidentin, pasojat veçanërisht në raport me viktimën dhe familjen e tij, nuk ka kundërshtuar dhe as nuk ka mohuar veprimet të cilat ai i ka kryer, duke marrë parasysh që akuzohet për veprime të kryera nga pakujdesia, mirëpo nuk ka pranuar fajësinë për shkak se ka qenë interes i drejtësisë dhe i tij që plotësisht të vërtetohen faktet që lidhen me veprimet konkrete, rrjedhën e ngjarjes dhe faktet që do qartësonin rrethanat që lidhen drejtpërdrejt me përgjegjësinë e tij penale. I bindur se ditën kritike ai është gjetur në një situatë pa zgjidhje, kur duke vozitur automjetin e tij në përshtatje të kushteve dhe rrethanave të rrugës ai befasisht është goditur nga një mjet - motoçikletë dhe është i bindur se në asnjë rrethanë, veprim apo kujdes të shtuar nuk do të kishte arrit të i shmanget këtij aksidenti. Ai është i bindur se ka vozitur në skajin e djathtë të rrugës nga drejtimi i lëvizjes së tij dhe brenda kufizimit të lejuar të shpejtësisë që do ti mundësonte evitimin e çdo pengese që vjen apo del para tij në pjesën e rrugës që mund të konsiderohet anë e tij e lëvizjes. Mungesa e shenjave horizontale dhe vertikale, sinjalistikës në rrugë, pamundëson që tani kemi një situatë të qartë për atë që ka ndodhur dhe kjo mungesë është njëra nga shkaktarët e aksidentit sepse viktima nuk ka arrit të përcaktoj shiritin e lëvizjes dhe ka dalur në mes të rrugës duke e goditur automjetin e të akuzuarit. Mirëpo gjykata nuk ka konstatuar këtë gjendje faktike duke dhënë besim provave që nuk janë të qarta, bindëse dhe të plota, që lënë hamendësim dhe dilema lidhur me atë se ku është saktësisht vendi, në cilën pjesë të rrugës saktësisht ka ndodhur kontakti i goditjes që quhet

pika goditëse. Mbrojtja e ka të pamundur që edhe mbi këtë bazë të mos i referohet refuzimit të propozimit për dëgjimit të dëshmitarit E.H- zyrtarë policor, në rrethanat që do të sqaronte dhe të hiqte çdo dilemë lidhur me konstatimin e saktë dhe të qartë se saktësisht në cilën pjesë të rrugës ka ndodhur goditja. Dilemat lidhur me këtë fakt bëjnë që aktgjykimi edhe sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike të jetë me të meta, jo i plotë sepse nuk ka arritur që plotësisht dhe saktësisht ti vërtetoj faktet që lidhen me gjendje faktike dhe krejt atë që ka ndodhur ditën kritike. Përkitazi me aplikimin e gabuar të dispozitave materiale mbrojtja thekson se në situatën kur i akuzuari në pjesën më të madhe të asaj që përshkruhet në aktakuzë nuk e kundërshton, duke paraqitur kundërshtimin e tij vetëm për faktet që përcaktojnë shkallën e përgjegjësisë penale që lidhen me përgjegjësinë dhe kontributin, gjegjësisht shkallën apo nivelin e këtij kontributi, është me rëndësi të theksojmë se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejtë dhe ka aplikuar gabimisht dispozitat materiale të kodit penal. Me këtë rast mbrojtja ka parasysh dispozitën e nenit 371 duke qenë se kjo dispozitë si e vetme nuk mund të paraqes dhe të përbëj vepër penale kur rrethanat e rastit tregojnë se aksidenti nuk është shkaktuar si pasojë e lëshimeve apo shkeljeve të rregullave të komunikacionit nga personi i cili ka vozit në gjendje të dehur. Tutje shton se dispozita në fjalë si e vetme nuk mund të aplikohet në rastet e aksidenteve me fatalitet sepse jo çdo herë personat që vozisin në gjendje të dehur janë shkaktarët e aksidentit. Në këto rrethana mbrojtja konsideron se janë plotësuar elementet thelbësore që nga veprimet e përshkruara në aktakuzë dhe bazuar në konstatimet e ekspertëve të vërtetohet se i akuzuari ka përgjegjësi të ndarë e cila dukshëm është dashur të ndikoj në marrjen e vendimit ashtu që i akuzuari bazuar në faktet e vërtetuara është dashur të lirohet nga përgjegjësia ose që dënimi të i shqiptohet në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale dhe veprimeve që janë vërtetuar se ai i ka kryer e jo të gjykohet si në këtë rast. Përkitazi me vendimin mbi dënim mbrojtja thekson se të akuzuarit dhe mbrojtjes nuk i është dhënë mundësia që të paraqesin në gjykatë rrethanat lehtësuese që do të ndikonin në marrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë sepse gjykata duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 356 të Kodit të procedurës penale, nuk ka caktuar seancë të vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese siç përcakton kjo dispozitë ligjore. Prandaj konsiderojmë se gjykata nuk ka marr parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, - rrethanat të cilat janë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale dhe kundërligjshmërisë, duke marrë parasysh rrethanat në të cilat ka ndodhur ky rast, sepse edhe po të kishte ekzistuar kujdesi i shtuar apo shpejtësia e lëvizjes më e vogël se sa kufizimi i lëvizjes në këtë pjesë, gjithsesi do të kishte ardhur deri tek aksidenti. Pra nga ajo që përmbajnë provat e aktakuzës del se i akuzuari nuk ka pas mundësi objektive që të i shmanget këtij aksidenti. E gjithashtu rrethanat personale dhe rrethanat se si ka vepruar i akuzuari pas aksidentit, mosha e tij, keqardhja e shfaqur për atë që ka ndodhur,

sjellja e tij pas rasatit, rrethanat familjare, fakti se i akuzuari është i martuar ka fëmijë, është kryefamiljare dhe mbajtës i familjes, është i punësuar dhe ka të punësuar mbi 15 punëtorë që varen nga ai, pajtimi me palën e dëmtuar dhe rrethanat tjera vërtetojnë se gjykata është dashur të aplikoj dispozitat e nenit 71 lidhur me rregullat për zbutjen e dënimit. Këto fakte të paraqitura nga mbrojtja vërtetojnë se gjykata është dashur që ti aplikoj edhe dispozitat e nenit 74 të KP-së, ndërsa në aktgjykim nuk ka paraqitur këto rrethana duke paraqitur vetëm rrethanat rënduese, në fakt gjykata fare nuk ka vlerësuar rrethanat lehtësuese prandaj vendimi si i tillë është i rëndë. Sidomos duhet theksuar faktin se gjykata në aktgjykim me rastin e paraqitjes së arsyeve për zbutjen e dënimit ka paraqitur rrethanat faktike që lidhen drejtpërdrejtë me shkallën e ulët të përgjegjësisë penale dhe rrethanat me të cilat është kryer vepra, kur konstatohet se deri tek aksidenti ka ardhur edhe si rezultat dhe kontribut i veprimeve të palës së dëmtuar se ka përgjegjësi të ndarë, qartazi vërteton se këto rrethana nuk janë vlerësuar drejtë nga gjykata dhe nuk janë në përputhje me dënimin e shqiptuar i cili në këto rrethana është tejet i lartë. Gjkata nuk ka vepruar as në përputhje me nenin 70 paragraf 3.1 sepse në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore dhe është vërtetuar se rrethanat e rastit vërtetojnë se kanë ekzistuar rrethana të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale se është vërtetuar se personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale, e veç kësaj edhe rrethanat tjera që përcaktohen në këtë dispozitë. Krejt këto bëjnë që edhe me aplikimin e zbutjes së dënimit gjykata nuk ka vepruar në përputhje me atë që ka përcaktuar neni 72 par.1 nën par. 1.3, e cila dispozitë përcakton se gjykata mund të zbusë dënimin deri në një vit. Mbi këto rrethana ka propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjkata e Apelit, pasi analizoi aktgjykimin e ankimuar së bashku me shkresat e lëndës, e duke i vlerësuar pretendimin ankimor përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.4 KPPK-së, me aprovimin e pjeshëm të përfq.ligjor-dëmtuarit dhe ankesës së prokurorisë tani më ky pretendim ankimor mbetet i pa objekt, pasi që kjo Gjykatë bazuar në dispozitën e nenit 398 par.1 pika 1.4 e lidhur me nenin 403 par. KPPK-së, e ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallë së parë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, gjeti se në pjesën tjetër aktgjykimi aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPRK-së, të cilat kishin për të kushtëzuar detyrimisht anulimin e tij, meqenëse dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye

të mjaftueshme për faktet vendimtare dhe arsyt në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhje së kësaj çështje juridike.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimi i ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe përf.ligjor-dëmtuari se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe atë të nenit 59 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 lidhur me nenin 64 të KPRK-së, rrjedhimisht në shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht nenit 385 të KPRK-së përkitazi me shqiptimin e dënimit plotësues për të akuzuarin qëndron dhe është i bazuar kjo për faktin se siç rezulton nga shkresat e lëndës, konkretisht nga aktakuza PP/I.nr.204/2021 e datës 09.11.2021 rrjedh se Prokurori i Shtetit në pikën IV të dispozitivit të aktakuzës ka propozuar që ndaj të akuzuarit K.G të shqiptohet dënimi plotësues - Ndalimi i drejtimit të automjetit andaj ky kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës nga këto arsye ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprës penale nga i akuzuari dhe nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se i njëjtit ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, pra gjykata e ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket pretendimeve ankimore nga mbrojtësi i të akuzuarit përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë, edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari K.G është kryes i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari K.G. në mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, për faktin se me datë 12.09.2021, rreth orës 22:00, në rrugën lokale Suharekë - fshati Peqan, ka drejtuar automjetin e markës “VË Transporter”, me tabela të

regjistrimit 04-884-IF, në kundërshtim me nenin 227, par.227.1 të Ligjit nr.02/L-70 për sigurinë në komunikacionin rrugor, në gjendje të paaftë, në ndikim të alkoolit, ku sipas alkooltestit me numër të njehsorit 46, me numër serik A430001, ka rezultuar se ka 1.11% (promil) dhe shkakton aksident në komunikacion rrugor që rezulton me vdekjen e A.B., në atë mënyrë që derisa ka qenë duke e drejtuar automjetin e cekur si më lartë, duke lëvizur në rrugën me përpjetë dhe me kthesë në të djathtë, me një pjesë të kamionetës del në shiritin e majtë të drejtimit të lëvizjes, ndërsa në atë moment në atë shiritë nga ana e kundërt ka qenë duke lëvizur motoçikleta - Scooter “TY- ..D A8”, të cilën ka qenë duke e drejtuar tani i ndjeri A.B, me ç’rast vjen deri te goditja me pjesën e përparme të anës së majtë të kamionetës të cilën e drejtonte i pandehuri, me dorëzën e anës së majtë të motoçikletës të cilën e drejtonte këtu tani i ndjeri A.B., si pasojë e së cilës goditje tani i ndjeri A.B. rrëzohet dhe përfundon jashtë rruge, në të djathtë të rrugës dhe me këtë veprim i pandehuri shkakton aksident që rezulton me vdekjen e tani të ndjerit A.B., ku shkak i vdekjes së të njëjtit si pasojë e aksidentit në trafik është konstatuar në bazë të raportit të autopsisë me numër MA21-276, të Institutit të Mjekësisë Ligjore, datë 13.09.2021.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se këtë çështje penale nuk ka mbetur në nivel dubioz apo dykuptimshëm asnjë fakt vendimtar. Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, në ankesën e tij. Kjo për faktin se në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, se për këtë veprë penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarit, fakt ky që është konstatuar dhe nga ekspertiza mjeko-ligjore e lartcekur përkitazi me gjendjen e të akuzuarit në të kuptuarit për veprimet dhe pasojat e tij në ditën kritike.

Sa i përket pretendimeve të Prokurorisë Themelore në Prizren, të dëmtuarit S.B. si dhe mbrojtësit të akuzuarit përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit gjen se, gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat që, konform dispozitës së nenit 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në

caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana lehtësuese gjykata e shkallës së parë mori parasysh faktin se i akuzuari për herë të parë ka ra në konflikt me ligjin, nuk ka qenë i dënuar më herët për ndonjë veprë penale, pasi që në shkresat e lëndës nuk kemi ndonjë provë - aktgjykim të plotfuqishëm se i akuzuari të ketë qenë i dënuar edhe më herët për ndonjë veprë penale, se është i martuar, ka 3 fëmijë, si dhe moshën e re, pasi që në momentin e kryerjes së veprës penale ka patur 33 vjet. Ndërsa si rrethana rënduese, gjykata morri parasysh pasojat e shkaktuara të veprës penale, që kanë rezultuar me shuarjen e jetës së një të riu të moshës 21 vjeçare dhe dhimbjen e shkaktuar familjes së tij. Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit ia shqiptoi dënimin nën minimumin e paraparë ligjor nga fakti se edhe i ndjeri ka kontribuar që të vjen gjer tek aksidenti i ditës kritike dhe se konform nenit 71 par.1 pika 1.2 të KP, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij penale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Pretendimet e prokurorisë Themelore në Prizren dhe ato të palës së dëmtuar S.B. për një dënim më të lartë nuk qëndrojnë, dhe ky kolegji penal i vlerëson si pretendime të përgjithësuara dhe të njëjtat nuk justifikojnë dënim më të rëndë po ashtu edhe pretendimet e paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit K.G. av. M.Q., për një dënim më të butë nuk qëndrojnë kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë ka pasur parasysh rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, mirëpo ka vlerësuar se në rastin konkret dënimi me burgim është adekuat dhe i drejtë. Po ashtu lidhur me pretendimin e ngritur nga mbrojtësi i të akuzuarit K.G. av. M.Q. se të akuzuarit dhe mbrojtjes nuk i është dhënë mundësia që të paraqesin në gjykatë rrethanat lehtësuese që do të ndikonin në marrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë sepse gjykata duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 356 të Kodit të procedurës penale, nuk ka caktuar seancë të vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese siç përcakton kjo dispozitë ligjore ky kolegji penal vlerëson se një pretendim i tillë nuk qëndron për faktin se neni 356 par.2 i KPPRK-së përcakton *“Kërkesa për seancë për caktimin e dënimit bëhet me shkrim ose në procesverbal pasi që i akuzuari të pranojë fajësinë apo para përfundimit të pritshëm të shqyrtimit gjyqësor. Prokurori i shtetit, i akuzuari apo mbrojtësi i tij mund të kërkojë mbajtjen e seancës me qëllim të paraqitjes së çështjeve të rëndësishme për caktimin e dënimit. Kërkesa për seancën e tillë nga i akuzuari ose mbrojtësi i tij nuk konsiderohet si pranim i fajësisë. 3. Nëse kërkesa nuk është parashtruar, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues poashtu mund të vendosë sipas detyrës zyrtare caktimin e seancës, për të marrë informacione shtesë me rëndësi për caktimin e dënimit.”*, ndërsa nga

procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 26.03.2024 nuk rezulton që mbrojtja apo i akuzuari të ketë paraqitur një kërkesë të tillë ashtu siç përcakton dispozita në fjalë.

Nga të lartcekurat ky kolegji penal mbështet përfundimin e shkallës së parë, duke vlerësuar se pretendimet ankimore të paraqitura nga ana e Prokurorisë, të dëmtuarit S.B. dhe mbrojtësit të akuzuarit, nuk janë të asaj natyre të cilat kishin për të justifikuar dhe ndikuar për një vendim dhe lartësi tjetër nga ai i shqiptuar si në aktgjykimin e ankimuar, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të këtij kolegji penal japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit e gjen si të drejtë dhe të ligjshëm dhe të njëjtin e pranon edhe kjo gjykatë pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 dhe 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.309/2024, datë 11.09.2024

Bashkëpunëtorë Profesionale,
Gresë Latifi

Anëtarët e kolegjit,
Vaton Durguti

Kryetar i kolegjit,
Zyhdi Haziri

Numri i lëndës: 2021:203434
Datë: 30.12.2024
Numri i dokumentit: 06669210

Skender Çoçaj
